



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 2578 prot.

Tiranë, më 12.05.2021

UDHËZIM

Nr. 6, Datë 12.05.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 10619, DATË
19.10.2018 "PËR KRIJIMIN, ADMINISTRIMIN DHE VËNIEN NË
DISPOZICION PËR PUBLIKUN TË REGJISTRIT ELEKTRONIK PËR
EKSPERTËT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 224/a, paragrafi i dytë dhe 224/d, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, si dhe të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr.10619, datë 19.10.2018, të Ministrit të Drejtësisë "Për krijimin, administrimin dhe vënien në dispozicion për publikun të Regjistrit Elektronik për Ekspertët", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Pas nënpikës "iv", të pikës 5, shtohet nënpika "v" me këtë përmbajtje:

v. Të jetë i pajisur me licencën profesionale përkatëse sipas fushës së ekspertizës për të cilën paraqet kërkesë për regjistrim.

2. Në pikën 11, pas fjalisë së parë shtohen fjalitë me përmbajtjen si më poshtë:

Në rast se eksperti nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë, sipas pikës 9 të këtij Udhëzimi, struktura përgjegjëse i kërkon ekspertit plotësimin e dokumentacionit. Eksperti ka detyrimin të plotësojë dokumentacionin e kërkuar brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga njoftimi i kërkesës.

3. Pika 14, ndryshon si më poshtë:

Aplikimi dhe dokumentet shoqëruese të dërguara në mënyrë elektronike nëpërmjet portalit e-albania merren në shqyrtim sipas radhës së regjistrimit të tyre. Aplikimi shqyrtohet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga marrja e kërkesës për regjistrim.

4. Pika 15, ndryshon si më poshtë:

Gjatë shqyrtimit të kërkesës për regjistrim, struktura përgjegjëse ka të drejtë:

- a. të kërkojë dokumentacion shtesë aplikantit me qëllim vlerësimin e përmbushjes së kritereve ligjore për regjistrim.
- b. të kërkojë informacion shtesë dhe verifikim të të dhënave nga institucioni që ka licensuar ekspertin.

Në të dyja rastet procedura e regjistrimit pezullohet deri në percjelljen e të dhënave të kërkuara.

5. Pika 16, ndryshon si më poshtë:

Struktura përgjegjëse pas kryerjes së verifikimit përpilon një relacion shpjegues, ku përmbledh shkurtimisht të dhënat e dokumentacionit të paraqitur dhe informacionin mbi përmbushjen ose jo të kritereve ligjore, ku në përfundim sugjeron pranimin ose refuzimin e aplikimit. Relacioni shpjegues i paraqitet nëpërmjet sistemit elektronik të Regjistrimit Elektronik të Ekspertëve për miratim Sekretarit të Përgjithshëm, pas miratimit të të cilit kryhet regjistrimi dhe njoftimi i ekspertit.

6. Pika 17, ndryshon si më poshtë:

Kërkesa nuk pranohet kur aplikanti nuk plotëson kriteret ligjore për regjistrim ose nuk plotëson dokumentacionin e kërkuar brenda afatit 15 (pesëmbëdhjetë) ditor. Në të dyja rastet, aplikanti njoftohet për shkaqet e mospranimit në adresën e komunikimit elektronik të deklaruar në formularin e aplikimit online.

7. Pika 18, ndryshon si më poshtë:

Aplikanti të cilit i refuzohet kërkesa ka të drejtën e ankimit pranë Ministrinë të Drejtësisë, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit. Ministri shqyrton ankesën dhe njofton ankuesin lidhur me të brenda 5 (pesë) ditëve nga data e depozitimit.

8. Pika 19, ndryshon si më poshtë:

Në rastin kur, pas shqyrtimit të ankimit, Ministri i Drejtësisë vlerëson se eksperti duhet të regjistrohet, procedohet me regjistrimin e tij në Regjistrimin Elektronik të Ekspertëve.

9. Pika 24, ndryshon si më poshtë:

Ministria e Drejtësisë në çdo rast ka të drejtë që:

- a. të nisë procedurën e pezullimit të thirrjes në gjykatë, nëse vihet në dijeni të një prej fakteve të lartpërmendura në këtë udhëzim ose të një pengese ligjore për ushtrimin e profesionit me karakter të përkohshëm.
- b. të nisë procedurën e çregjistrimit të ekspertit nga Regjistri Elektronik i Ekspertëve, nëse vihet në dijeni të një prej fakteve të lartpërmendura ose të mungesës së kritereve ligjore të parashikuara në pikat 4 dhe 5 të këtij udhëzimi.

Në të dyja rastet Ministria e Drejtësisë njofton paraprakisht ekspertin, i cili brenda 15 ditëve nga njoftimi ka të drejtë të paraqesë parashtrimet e tij në lidhje me procedurën e iniciuar.

10. Pas pikës 24, shtohen pikat 24.1, 24.2 dhe 24.3 me këtë përmbajtje:

24.1. Struktura përgjegjëse pas vlerësimit të informacioneve mbi të dhënat e konstatuara si dhe parashtrimeve të ekspertit, sugjeron pezullimin ose çregjistrimin e ekspertit nga Regjistri Elektronik i Ekspertëve, i cili i paraqitet për miratim Sekretarit të Përgjithshëm. Eksperti pezullohet ose çregjistrohet nga Regjistri Elektronik i Ekspertëve pas miratimit nga Sekretari i Përgjithshëm, fakt për të cilin njoftohet brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e vendimit.

24.2. Eksperti kundër vendimit për pezullim ose çregjistrim nga Regjistri Elektronik të Ekspertëve ka të drejtën e ankimit brenda 5 (pesë) ditëve pranë Ministrisë së Drejtësisë. Ministri shqyrton ankesën dhe njofton ankuesin lidhur me të brenda 5 (pesë) ditëve nga data e depozitimit.

24.3. Në rastin kur, Ministri i Drejtësisë vlerëson se ankimi është i pranueshëm dhe i bazuar, vijohet me procedurën e heqjes së pezullimit ose reregjistrimin e ekspertit. Eksperti për veprimin e realizuar njoftohet brenda 3 (tre) ditëve.

11. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
ETILDA GJONAJ (SALIU)

